

VENDIM
Nr. 584, datë 18.10.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 44, DATË 1.2.2023, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR
VITIN 2023, NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË
TË SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 44, datë 1.2.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2023, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, togfjalëshi “1 152 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy)” zëvendësohet me “1 158 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë)”.

b) Në shkronjën “a”, të pikës 1, shifra “12” bëhet “18”.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku